



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT LUMOR DRIN-BUNË

Nr. 22 dat. Dt 08/07/2025

VENDIM

Nr. 22, datë 08.07.2025

PËR

MIRATIMIN E AUTORIZIMIT PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR TURIZËM, ARGËTIM, LUNDRIM PËR
ARGËTIM, Z.ALIM GURRA P.F

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e autorizimit për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim, z.Alim Gurra, me vendndodhje: Deti Adriatik, Velipojë, Bashkia Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Deti Adriatik

Vendndodhja e burimit (KRGJSH):

- X=452177;	Y=4636419;	Z=0 m.m.n.d;
- X=452216;	Y=4636412;	Z=0 m.m.n.d;
- X=452171;	Y=4636390;	Z=0 m.m.n.d;
- X=452211;	Y=4636383;	Z=0 m.m.n.d;

- Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji. Lojra për argëtim.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

